3.Kunder ketij vendimi mund te behet ankim i veçante ne Gjykaten e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, brenda 5 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paditeses Kristina Dulellari dhe te padituri Fezo Dulellari.

U shpall ne Korçe sot me date 31.01.2024, ora 11:16.

SEKRETARE
MANTUELA BESHELLO

GJYQTARE
LULJETA KOLONJA

SHPENZIMET GJYQESORE
Redaktim kerkesepadie pa tarife
Taksa mbi aktet 3000 leke, te parapaguara nga paditesja
Pulla poste 210 te parapaguara nga paditesja
Shperblim per avokatin e paditeses nuk ka dokumentacion
Shuma totale e shpenzimeve 3210 leke, te parapaguara nga paditesja

kunder te paditurit Fezo Dulellari, me objekt – Zgjidhja e marteses mes paditeses dhe te paditurit. Zgjidhja e pasojave te zgjidhjes se marteses.

Ne seancen pergatitore te dates 31.01.2024, ora 11.00 paditesja Kristina Dulellari dhe perfaqesuesi i zgjedhur prej saj me deklarim ne seance avokati Sazan Selmani, nuk u paraqiten. Paditesja kishte dijeni rregullisht per diten dhe oren e seances pergatitore nga seanca e dates 16.11.2023 ne te cilen ishte e pranishme dhe kishte marre persiper dhe njoftimin e perfaqesuesit te saj.

Gjykata hetoi ne lidhje me shkaqet e mosparaqitjes se paditeses dhe perfaqesuesit te saj dhe nga verifikimi i kryer rezultoi se paditesja dhe perfaqesuesi i zgjedhur prej saj nuk kishin paraqitur ne sekretarine e gjykates ndonje shkak te arsyeshem per mosparaqitjen ne gjykim.

Ne nenin 179 te K.Pr.Civile jane parashikuar pasojat juridike te mosparaqitjes se paleve, ku ne paragrafin e dyte te ketij neni eshte parashikuar se:
« Nese paditesi, pa ndonje shkak te arsyeshem, nuk paraqitet ne seance pergatitore ose ne seance gjyqesore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorezuar deklaraten e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorezuar deklaraten e mbrojtjes, mund te kerkoje vijimin e gjykimit ne mungese te paditesit dhe gjykata, kur vlereson se qendrimi i te paditurit ka shkak te ligjshem, vijon gjykimin ne mungese te paditesit ».

Gjykata e ndodhur ne keto rrethana, nderpreu vazhdimin e metejshem te seances pergatitore dhe konkludoi ne zbatim te neneve 179/2 dhe 299/ç te K.Pr.Civile ne pushimin e gjykimit te çeshtjes. Marrja e vendimit te pushimit perligjet me faktin qe paditesja dhe perfaqesuesi i zgjedhur prej saj nuk u paraqiten ne gjykim pa shkak te arsyeshem.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 127, 179/2, 299/ç, 301, 444 te K.Pr.Civile

VENDOSI

1.Pushimin e gjykimit te çeshtjes civile me nr.422/175/00267-399 regj.them., date 25.05.2022 regjistrimi, qe i perket:

Paditese - Kristina Dulellari

I paditur - Fezo Dulellari

Objekti – Zgjidhja e marteses mes paditeses dhe te paditurit. Zgjidhja e pasojave te zgjidhjes se marteses.

2.Shpenzimet gjyqesore ne masen 3210 (tre mije e dyqind e dhjete) leke i lihen ne ngarkim paditeses.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

NR.422/175/00267-399 REGJ.THEM. **NR.41-2024-340 (96) VENDIMI**
DATË REGJISTRIMI 25.05.2022 **DATË 31.01.2024**

VENDIM
"NË EMËR TE REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e përbërë nga:

GJYQTARE – LULJETA KOLONJA

asistuar nga sekretare gjyqesore Mantuela Beshello, ne Korçe, sot ne date 31.01.2024, ora 11:12 mori ne shqyrtim ne seance pergatitore çeshtjen civile me nr.422/175/00267-399 regj.them., qe i perket:

PADITESE: Kristina Dulellari, e bija e Hyqmet dhe e Burbuqe, e datelindjes 15.05.2002, lindur dhe banuese ne Slatine, Pogradec, e perfaqesuar ne gjykim nga avokati i Dhomes se Avokatise Korçe Sazan Selmani, me nr.4166 licence dhe NIPT L04014602D, i zgjedhur me deklarim ne seance.

I PADITUR: Fezo Dulellari, i biri i Safet dhe i Mamude, i datelindjes 10.05.1994, lindur ne Osnat Pogradec dhe banues ne Podgorie Koçe.

OBJEKTI: Zgjidhja e marteses mes paditeses dhe te paditurit. Zgjidhja e pasojave te zgjidhjes se marteses.

BAZA LIGJORE: Nenet 132 e vijues, nenet 143, 146/1 te Kodit te Familjes.

Gjykata pasi çeli ne oren 11.12 seancen pergatitore te dates 31.01.2024, ora 11.00,

VEREN

Se paditesja Kristina Dulellari i eshte drejtuar ish Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec aktualisht Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korçe me kerkesepadi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 30.10.2024

BASHKIA MA
Zyra e Protok...
Nr. 5193 Prot.....
Date 6.11.24 Nenshkrimi

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : **Njësia Administrative Vreshtas**

Për shtetasin/en: Fezo Dulellari
Me adresë: Fshati Podgorije,Korçë

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr.96 dt. 31.01.2024 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi dëftesa e komunikimit është kthyer e pakonfirmuar dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Për Njësinë Administrative/Bashkinë

(emër, mbiemër, firmë)

-Nj-A-Vreshtas
- STIRR
Dt 06.11.2024

233
Dt 06.11.2024